

RAPORT MBI ZBATIMIN E PROJEKTIT:

ADAPTIMI NË NDRYSHMET KLIMATIKE NË BALLKANIN PERËNDIMOR “SISTEMI PËR PARALAJMËRIM TË HERSHËM NGA PËRMBYTJET NË PELLGUN DRINI/BUNA” Nr Projektit: 11.9774.8-006.00

Përfitues: (Kosova, Shqipëria, Maqedonia Mali Zi)

Komponentët e projektit:

- 1. Ngritja e Sistemit të paralajmërimit të hershëm**
- 2. Menaxhimi i Integruar i Thatësirave**
- 3. Programi për modelime hidrologjike - PHANDA RHEI**

**DONATORË: GIZ-i Gjerman
Periudha: 2012/2014**

Prishtinë, 2014

HYRJE

Çështja e ndryshimeve klimatike gjithë një e më shumë është bërë temë e diskutimeve dhe aktiviteteve në nivelet më të larta politike, ekonomike, intelektuale dhe shkencore në përmasa globale, rajonale dhe lokale, ku si shkak janë pasojat dhe efektet negative të këtyre ndryshimeve të cilat çdo ditë e më shumë janë më të shprehura nëpër regjione dhe vende të ndryshme të botës por edhe tek ne, duke u shkaktuar përmbajtje me përmasa katastrofike po ashtu edhe paraqitja e temperaturave të larta ekstreme duke shkaktuar thatësi. Këto procese negative zakonisht janë duke u shoqëruar me stuhi të fuqishme tropikale (ciklonet), të cilat shkaktojnë humbje në njerëz dhe dëme të konsiderueshme materiale, dhe humbje ekonomike.

Ndryshimet e tilla lënë pasojë afatgjatë në aktivitetin njerëzor (bujqësi, infrastrukturë, ekonomi, psikologjinë e njerëzve etj), pastaj në botën bimore dhe shtazore dhe në habitatet e tyre. Këto zhvillime kërkojnë angazhimin e institucioneve relevante brenda çdo shteti në mënyrë që të krijohen kapacitetet e nevojshme institucionale duke përfshirë ato humane, teknike, legjislativë etj, e të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin e tyre me ato të BE, WMO¹ etj. si dhe të bëhet informimi dhe sensibilizimi i qytetarëve dhe i opinionit të gjerë në kohën e duhur.

Nga ndikimi i këtyre proceseve, edhe Kosova shpesh është duke u ballafaquar me këto dukuri (përmbajtje dhe thatësira), të cilat janë duke shkaktuar dëme dhe shqetësime në vazhdimësi, e për të cilat nevojiten angazhime, duke sensibilizuar institucionet relevante në mënyrë që të krijohen politika (ligje, rregullore, normativa, direktiva, udhëzues etj), të cilat kanë të bëjnë me fatkeqësitë elementare natyrore.

Si pjesë e aktiviteteve në ngritjen e kapaciteteve institucionale, edhe Kosova është e përfshirë në rrjedhat dhe proceset integruese si ato rajonale ashtu edhe ato Evropiane dhe më gjerë, duke përfituar në aspektin e trajnimit të stafit profesional në fusha të caktuara, por edhe duke përfituar donacione dhe mjete teknike të cilat kanë refleksione pozitive në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe infrastrukturore.

Ndër projektet e realizuar së fundmi është ai i **“Ndryshimeve Klimatike dhe i adaptimit në Ballkanin perëndimor”**, nëpërmjet ngritjes së Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të përmbajtjeve në pellgun e Drinit, si donacion i qeverisë Gjermane nëpërmjet GIZ-it, ku përfitues janë Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi.

QËLLIMI

Qëllimi kryesorë i këtij projekti është që institucionet nacionale të vendeve përfituese të cilat merren me monitorim të elementeve dhe dukurive meteorologjike dhe hidrologjike, të krijojnë kapacitete të mjaftueshme humane, teknike legjislativë etj, në mënyrë që të jenë në gjendje që të monitorojnë duke siguruar informacione kualitative dhe të rregullta të këtyre proceseve, në mënyrë që të kenë mundësi për të parashikuar, prognozuar dhe paralajmëruar me kohë lidhur me motin, klimën hidrologjinë etj.

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është integrimi rajonal dhe ndërkombëtarë, duke pas si synim bashkëpunimin reciprok dhe në shkëmbim të informacioneve, në mënyrë që institucionet relevante nacionale të kenë mundësi që të jenë operacional gjatë 24/7².

¹ WMO Organizata Botërore e Meteorologjisë


²(24/7)24 orë në ditë 7 ditë në javë

Ngritja e kapaciteteve institucionale, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtarë si dhe shkëmbimi i informacioneve do të ishte i dobishëm për përgatitje sa më të mirë dhe informim në kohën e duhur të qytetarëve dhe akterëve të tjerë, para gjatë dhe pas ndodhjes së një fatkeqësie natyrore të shkaktuara nga reshjet intensive të shiut, shkrirja e shpejt e borës e etj të cilat do të shkaktonin përmbytje, ose mungesa e ujit në një zonë të caktuar e shkaktuar nga deficit i reshjeve për një periudhë të gjatë.

PERFITIMET (TE ARRITURAT) E IHMK NGA PROJEKTI

Ky projekt ka filluar gjatë vitit 2012 dhe është zhvilluar në faza duke përfunduar me vendosjen dhe instalimin e instrumenteve matëse meteorologjike dhe hidrometrike në: Lumin Drini Bardhë, stacioni hidrometrik/**Gjonaj**, dhe lumi Bistrica e Pejës stacioni/**Grykë e Rugovës**: (Sensori automatik i nivelit të ujit së bashku me sistemin për transferimin e të dhënave në serverin qendrorë në Prishtinë përmes GSM/GPRS), 3 stacione meteorologjike në **Pejë, Junik dhe Prizren** (Shimatës automatik të cilët e bëjnë matjen e sasisë dhe intensitetin e reshjeve, njëherazi nxemësi i vendosur në të, e bën shkrirjen e borën dhe akullit gjatë sezonit të ftohet, duke mundësuar kështu regjistrimin e reshjeve të ngurta si dhe serverin qendrorë ne te cilin është instaluar programi softuerik Demasdb.

Harta e stacioneve monitoruese hidro meteorologjike e pellgut Drini/Buna



STACIONET METEOROLOGJIKE/KLIMATOLOGJIKE

1. Peja – Në këtë stacion ekzistues meteorologjik, është vendosur një shimatës automatik i prodhuesit Gjerman SEBA, i cili regjistron sasinë dhe intensitetin e reshjeve si dhe temperaturën e ajrit, nga ku keto të dhëna pastaj transferohen në serverin qendrorë në IHMK .

Foto 1. Pamje e shimatësit automatik me sistemin e integruar të parametrave shtesë



2. **Junik** – Në këtë stacion, bëhet regjistrimi automatik i sasisë dhe intensitetit të reshjeve, si dhe temperatura e ajrit

Foto 2. Pamje nga stacioni në Junik



3. **Prizren** - në këtë stacion, bëhet regjistrimi i këtyre parametrave: sasia dhe intensiteti i reshjeve, lagështia e ajrit, shtypja atmosferike dhe temperatura e ajrit.

Foto 3/4 Pamje e stacionit automatik në Prizren




STACIONET HIDROMETEIKE

1. **Gjonaj** - lumi Drini i Bardhë

Ky është stacion ekzistues hidrometrik me rëndësi të veçantë, pasi që ka karakter ndërkombëtarë, duke u ndodhur në afërsi të kufirit më Shqipërinë, si dhe i përmbledh të gjitha ujërat të cilat drenojnë në rrafshin e Dukagjinit.

Në këtë stacion është vendosur sensori i cili e bën regjistrimin automatik të nivelit të ujit në interval kohorë prej 15 min, me mundësi qasje në kohe reale përmes GSM/GPRS.

Foto 5/6 Pamje nga stacioni hidrometrik në Gjonaj



2. **Grykë të Rugoves** – lumi Bistrica e Pejës – në këtë stacion ekzistues hidrometrik, është vendosur sensor i cili e bën regjistrimin automatik të nivelit të ujit në interval prej 15 min, si dhe ruajtjen e të dhënave në memoriën e tij (datallogger), duke mundësuar qasje në çdo kohë përmes sistemit të GSM/GPRS dhe transferimit e të dhënave në kohë reale në serverin qendrore të IHMK në Prishtinë.

Foto 7/8 Pamje nga stacioni hidrometrik në Grykë të Rugovës



SERVERI QENDRORE

Përmes këtijë projekti është instaluar edhe serveri qendrorë në të cilin është i programuar softueri **Demasdb**, për transferimin e të dhënave në kohë reale në softuerin qendrorë dhe për të shkëmbyer informacionet me institutet hidrometeorologjike ndër regjionale, në mënyrë që të arrihet efikasitet në informim të parakohshëm të ndonjë rreziku nga vershimet eventuale. Në vazhdim mundë të shihni pamjet nga ky softuer.

Foto 9/10 Pamje nga transferimi i të dhënave në kohë reale , niveli i ujrave dhe temp. e ajrit



Po ashtu personeli i sektorit të hidrologjisë dhe meteorologjisë në IHMK kanë përfutur trajnime për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm të Vershimeve, Menaxhimi i Integruar i Thatësirave (kalkulimi i SPI-Indeksi i Standardit të Precipitimit) dhe për modele hidrologjike - PHANDA RHEI.

Vlera e investimeve në IHMK përmes këtijë projekti ka arrit në **50.238,00 euro**. Për të gjitha këto investime në teknologji dhe ngritjen profesionale të personelit të IHMK, IHMK falënderon qeverinë Gjermane dhe GIZ-in të cilët kontribuar dhe bënë punë të palodhshme me personelin e IHMK gjatë implementimit të projektit..